

# ECJE NË NATYRË



**Përshkrimi:** Të vëzhgojmë dhe të njohim natyrën në zonën ku banojmë.

## Materiale

Gjete (p.sh: gjete të pemëve frutore apo të tjera), gurë, shkopinj

## Aftësi Parësore

Aftësia për të dalluar dhe për të klasifikuar cilësitë e objekteve (masën ngjyrë formën strukturën, etj.).

## Aftësi Dytësore


## Hapat

1. Dilni jashtë dhe mblidhni gjete nga pemët apo që kanë rënë në tokë.
2. Pasi të keni mbledhur disa prej tyre, kthehuni brenda (klasës apo shtëpisë) .
3. Bisedoni apo përshkruani gjethet e mbledhura duke cilësuar ngjyrën, formën, strukturën, ndjesinë që të japin kur preken, ose erën që kanë kur janë të thata ose kanë qëndruar në tokë për një kohë të gjatë.
4. Më pas, vendosini njëra mbi tjetrën dhe klasifikojini sipas ngjyrës.
5. Vendosini sërish njëra mbi tjetrën dhe klasifikojini sipas formës.
6. Më pas, klasifikojini gjethet sipas mënyrës që dëshiron i.

## Vazhdimësia dhe Variacione

7. Objekte të tjera që mund të mblidhen: fara, gurë, lule, insekte, etj.
8. Objektet mund të klasifikohen sipas strukturës, peshës apo çdo kriteri që fëmija dëshiron.

# TË MASIM ME SHPUTËN E KËMBËS



**Përshkrimi:** Të masim objekte të ndryshme duke përdorur shputën e këmbës.

## **Materiale**

Shkumës ose lapustila, tabelë ose fletë të bardhë, objekte brenda shtëpisë ose klasës

## **Aftësi Parësore**

Aftësi për të krahasuar gjatësitë përfshi edhe përdorimin e llogaritjes së përafërt si një llogarije jo standarde (si këmba, dora etj)

## **Aftësi Dytësore**

## **Hapat**

1. Zgjidhni një objekt për të matur nga mjedin ku ndodheni ('objekti duhet të jetë i gjatë' qilim, rrugicë, tavolinë).
2. Llogarisni me përafërsi gjatësinë e tij.
3. Shihni sesi e keni bërë llogaritjen duke provuar ta matni gjatësinë me shputën e këmbës tuaj. Vendosni këmbët njëra para tjetrës, në mënyrë që thembra e këmbës së parë, të prekë gishtin e madh të këmbës së dytë. Ecni duke i vendosur këmbët njëra para tjetrës, pa lënë hapësira boshe (thembra duhet të prekë gishtin e madh të këmbës së prapme)
4. Numëroni hapat për të logaritur masën. Vëreni nëse parashikimi / llogaritja juaj e përafërt ishin në rregull
5. Më pas, zgjidhni dy objekte me gjatësi të përafërta. Përdorni teknikën e matjes me shputën e këmbës, për të parë se cili prej objekteve është më i gjatë.
6. Më pas, masni distancën midis dy objekteve (ky aktivitet mund të zhvillohet në ambiente të brendshme dhe të jashtme) duke përdorur të njëjtën teknikë.

## **Vazhdimësia dhe Variacione**

- Ky aktivitet mund të zhvillohet duke përdorur edhe objekte të tjera, si p.sh. një kub apo lodra të ndryshme

# FORMAT NË MJEDIS OSE NATYRË



**Përshkrimi:** Të gjejmë forma në mjedisin përreth shtëpisë, klasës ose oborrit

## Materiale

Fletë për gjueti formash (shihni udhëzimet e mëposhtme), letër, lapsa, materiale vizatimi (lapustila ose lapsa me ngjyra)


## Aftësi Parësore

Aftësia për të dalluar format e njohura në natyrë

## Aftësi Dytësore

## Hapat

1. Për të përgatitur një 'Fletë për gjueti formash', vizatoni në fletë një katror, një rreth ose forma të ngjashme:



*Etiketa e pikëve*

2. Dilni jashtë në oborr. Vendosni një vijë pranë formës së rrethit në formën e pikëve sa herë që të shikoni një objekt në formë rrethi, në mënyrë që ta keni më të lehtë për t'i mbajtur mend. Veproni njëjloj me objektet në formë katrori. Mundohuni të gjeni të paktën pesë rrathë dhe pesë katrorë.
3. Kthehuni brenda në klasë dhe kërkoni nga fëmijët të tregojnë disa nga rrathët dhe katrorët që kanë gjetur.
4. Më pas, merrni një fletë dhe vizatoni një nga rrathët apo katrorët të shënuar nga fëmijët.
5. Pasi ta keni përfunduar veprimtarinë, ruajeni ose ngjiteni letrën në murin e klasës

## Vazhdimësia dhe Variacione



Save the Children

# BINGO



**Përshkrimi:** Lojë Bingo me forma gjeometrike.

## Materiale

Karta me figurageometrike, karta bingo dhe guriçka

## Aftësi Parësore


Fëmijët njihen me format dhe përforcojnë njohuritë rreth tyre.

## Aftësi Dytësore

Aftësia e përqendrimit duke u zbavitur

## Hapat

1. Për ta zhvilluar këtë veprimtari, përgatitni karta me 9 forma te ndryshme. Të gjithë fëmijët duhet të kenë nga një kartë, e cila duhet të jetë e ndryshme për të gjithë. Karta duhet të jetë si më poshtë:



2. Zgjidhni një lojtar nga grupi si 'drejtues' të lojës, i cili duhet të përziejë kartat me forma dhe më pas t'i 'shqiptojë me zë të lartë', duke ia treguar klasës njëra pas tjetrës.
3. Ndërkohë që drejtuesi tregon kartën me një formë të caktuar, fëmijët dëgjojnë me vëmendje emrin e formës. Nëse arrijnë ta gjejnë në kartën e tyre, ato duhet ta shënojnë duke vendosur sipër formës përkatëse një gur të vogël.  
Nxënësi që e plotëson i pari kartën, fiton!

## Vazhdimësia dhe Variacione

– Ndajini fëmijët në grupe të vogla, ku secili prej tyre duhet të ketë një drejtues (zgjidhni një nxënës që i njeh mirë format. Sigurohuni që të zgjidhni edhe vajza, edhe djem). Ai/ajo merr një tufë me karta të formave dhe ua tregon fëmijëve të tjerë, të cilët duhet të gjejnë formën (e ngjashme me demonstrimin e mësueses apo të prindit). Kështu, fëmijët kanë më shumë mundësi për t'u praktikuar.



Save the Children